



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c) e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008, 4 Qershor 2008), nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe në zbatim të nenit 36, paragrafi 3 i Rregullës financiare nr. 01/2013 – MF - Shpenzimi i parave publike dhe në bazë të nenit 52, pika h) dhe nenit 33, paragrafi 33.1, pika a) e Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110-391, të datës 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 2.6.2025, miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE NGA KOMUNA E PRISHTINËS

KAPITULLI I **Dispozitat e përgjithshme**

Neni 1 **Qëllimi**

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës së Prishtinës të ndajë mjete financiare pa kthim, nga kategoria e subvencioneve, në fushat e cekura, për persona fizikë dhe juridikë.

2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga organet komunale gjatë ndarjes së subvencioneve për përfituesit si persona fizikë dhe juridikë.

Neni 2 **Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim si në vazhdim:

Subvencionet - në kuptim të kësaj rregulloreje, subvencionet përfshijnë transferet e njëanshme, të pakthyeshme të mjeteve buxhetore të institucionit, në llogarinë rrjedhëse të përfituesve, të ardhurat

e të cilëve nuk mbulojnë shpenzimet e caktuara përkatëse për arritjen e një qëllimi të ligjshëm për interes publik.

Pagesa e pakthyeshme - është e njëanshme, atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim ose kundërvlerë për pagesën.

Përfituesi - nënkupton personat fizikë dhe juridikë që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e komunës dhe në pajtim me Ligjin për Ndarjet Buxhetore.

Ndërmarrje publike lokale – nënkupton ndërmarrje publike lokale në pronësi të Komunës së Prishtinës ose në të cilën Komuna e Prishtinës ka aksione.

Banor rezident - nënkupton personin që jeton dhe vepron në komunë dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.

Raporti narrativ - nënkupton të gjitha të dhënat e aktiviteteve që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit, të cilat duhet të dorëzohen nga përfituesi i subvencionit.

Raport financiar - nënkupton që përfituesi i subvencionit t'i dorëzojë të gjitha dëshmitë për shpenzimet financiare, ashtu siç janë kërkuar në projektpropozim.

Krijimi i veprës së re - nënkupton stimulimin e krijuesve përmes mbështetjes financiare për krijimtari të veprave të reja vizuale-figurative, si p.sh. pikturë, skulpturë, grafikë, dizajn, mozaik, mural, performancë, vepër multiaplikative etj.

Rezidenca artistike - nënkupton stimulimin e bashkëpunimit të organizatave joqeveritare kulturore me krijues dhe veprimtarë të huaj kulturorë (kuratorë dhe menaxherë kulturorë), të cilët ftohen për qëndrim në Komunën e Prishtinës. Rezidencat kulturore mund të jenë në fushën e artit vizuel, literaturë, muzikë, teatër, si dhe shumëdisiplinore.

Kompozimi i veprës së re muzikore - nënkupton stimulimin e krijuesve përmes mbështetjes financiare për krijimtari të re. Vepra e re muzikore mund të jetë solistike, ansamble kamertale, vokale, apo vokalo-instrumentale.

Audio incizim - nënkupton stimulimin e prodhimit të audio-incizimeve të muzikës klasike, xhaz, rok dhe alternative. Mbështetje jepet për incizim në studio dhe masterim.

Neni 3

Limitet buxhetore

1. Komuna ndan subvencione duke u bazuar në Ligjin e Buxhetit për vitin fiskal, për të cilën ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.

2. Komuna ndan subvencione për këto fusha: arsim, zhvillim ekonomik, bujqësi, shëndetësi, mirëqenie sociale, barazi gjinore, kulturë, rini dhe sport, siguri, ndërmarrje publike lokale, digjitalizim, promovim si dhe duke mos u kufizuar edhe në fusha tjera.

3. Ndarja e subvencioneve për OJQ-të që kalojnë shumën prej 500 €, bëhet në bazë të Rregullores MF-nr-04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

4. Ndarja e subvencioneve sipas kësaj rregulloreje do të zbatohet për të gjitha rastet, ashtu siç është paraparë në nenin 2, pika 5 të Rregullores MF-nr-04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 4

Subjektet përfituese të subvencioneve

Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për persona fizikë, OJQ-të dhe në raste të veçanta personat juridikë që ndërlidhen me ndonjë aktivitet nga fushat e përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 5

Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve nga komuna mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike apo në raste të veçanta, në bazë të kërkesës së arsyetuar, atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të komunës, përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi. Këto procedura zhvillohen në pajtim me Rregulloren MF-nr-04/2017, si dhe me dispozitat e parapara të kësaj rregulloreje.

3. Ndarja e subvencioneve sipas kërkesave të veçanta aplikohet për kategorinë e subvencioneve të cilat i ndan Kryetari i Kryeqytetit, në të gjitha fushat e përcaktuara me këtë rregullore.

3.1. Subjektet përfituese sipas paragrafit 2 të këtij neni, për të njëjtin projekt nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Kryetarit sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 6

Përfshirjet nga ndarja e subvencioneve

1. Përfitues të subvencioneve të ndara nga komuna nuk mund të jenë personat fizikë jorezidentë të Komunës të Prishtinës.

2. Asnjë subjekt nuk mund të jetë përfitues i subvencioneve, nëse paraprakisht nuk e ka mbyllur subvencionin paraprak në pajtim me kushtet e përcaktuara në kontratën për ndarjen e subvencioneve.

3. Obligimet e përcaktuara në marrëveshjen për ndarjen e subvencioneve, nëse nuk përmbushen nga mospërgjegjësia e përfituesit për 3 (tri) vitet e ardhshme, përfituesi humb të drejtën në përfitim nga secila kategori e subvencioneve.

Neni 7

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve

1. Themelimi, përbërja, kohëzgjatja dhe mandati i Komisioneve për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve përmes thirrjes publike bëhet nga Kryetari i Komunës në pajtim me dispozitat e Rregullores MF-nr-04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2. Themelimi, përbërja, kohëzgjatja dhe mandati i Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të veçanta për ndarje të subvencioneve të Kryetarit të Kryeqytetit, bëhet si në vijim:

2.1. Komisioni përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, tre (3) anëtarë përfaqësues nga komuna, nga të cilët një (1) duhet të jetë nga drejtoria përkatëse e cila shpall thirrjen për subvencion dhe dy (2) anëtarë ekspertë të jashtëm nga shoqëria civile. Kryesuesi i këtij komisioni duhet të jetë nëpunës civil nga Komuna e Prishtinës.

2.2. Komisioni do të ketë dy (2) anëtarë zëvendësues, një (1) nëpunës civil nga komuna dhe një (1) nga shoqëria civile, të cilët në rastet e caktuara e zëvendësojnë anëtarin e rregullt në rast të mungesës së tij apo anëtarin i cili ka deklaruar konflikt të interesit.

2.3. Mandati i Komisionit sipas paragrafit 2 të këtij neni është njëvjeçar me mundësi të vazhdimi.

2.4. Komisioni duhet të ketë përfaqësim të balancuar gjinor.

3. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, veprojnë në pajtim me ligjin, këtë rregullore dhe konform autorizimeve që jepen nga Kryetari i Komunës.

4. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, mbajnë përgjegjësinë për zbatimin e drejtë të kriterëve për ndarje të subvencioneve.

5. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e subvencioneve, duhet të deklarojnë paraprakisht mundësinë e ekzistencës së interesit të tyre privat lidhur me vendimmarrjen në raste të caktuara, që mund të jenë shkak për lindjen e konfliktit të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.

Neni 8

Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vlerësues dhe vendimmarrja

1. Detyrat, përgjegjësitë, procedura e vlerësimit dhe e vendimmarrjes së komisioneve vlerësuese për ndarjen e subvencioneve sipas thirrjes publike, si dhe ato sipas kërkesave të veçanta bëhen në pajtim me dispozitat e nenit 16 të Rregullores MF 04/2017.
2. Komisioni bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, brenda afatit prej 45 ditëve pas përfundimit të afatit të shpalljes publike dhe vepron në pajtim me legjislacionin për financat publike, dispozitat e kësaj rregulloreje dhe legjislacionin në fuqi.
3. Vendimet e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të komisionit.
4. Komisioni mban procesverbal gjatë mbledhjeve, i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit.
5. Brenda pesë (5) ditëve të punës, pas marrjes së vendimit nga komisioni, lista e përfituesve të subvencioneve, e cila publikohet në ueb-faqen zyrtare, si dhe në tabelën e shpalljeve publike të komunës.
6. Pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes së përfituesve, komisioni në afat prej 15 ditëve, pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin e subvencionit, i paraqet raport me shkrim Kryetarit të Kryeqytetit i cili e prezanton gjithë mbarëvajtjen e procesit.

Neni 9

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisione me mandat njëvjeçar për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve.
2. Komisioni do të jetë në përbërje prej pesë (5) anëtarëve. Kryetari dhe anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve, duhet të jenë shërbyes civilë, një (1) anëtar duhet të jetë zyrtar ligjor, si dhe duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.
3. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e mbajtura, i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit.
4. Anëtarë të Komisionit për vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve, nuk mund të jenë zyrtarët të cilët kanë qenë pjesë e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.

Neni 10
Parashtrimi dhe zgjidhja e ankesave

1. Ankesa parashtrohet në afat prej shtatë (7) ditë pune pas njoftimit të vendimit preliminar të Komisionit vlerësues për mospërfshirje në publikimin e listës preliminare të përfituesve të subvencioneve.
2. Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave dhe të marrë vendim në afat prej 10 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor për paraqitjen e ankesave.
3. Komisioni për shqyrtimin e ankesave gjatë vendimmarrjes, vepron në bazë të Ligjit për Procedurën Administrative dhe dispozitave të kësaj rregulloreje.
4. Vendimet e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve, merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të komisionit.
5. Brenda afatit prej tri (3) ditë pune pas vendimmarrjes të Komisionit për shqyrtimin e ankesave, bëhet publikimi i listës përfundimtare të përfituesve të subvencioneve të fushës përkatëse.

Neni 11
Zbatimi i vendimit

1. Vendimi i Komisionit vlerësues për ndarjen e subvencioneve bëhet i zbatueshëm, nëse:
 - 1.1. nuk është paraqitur ankesë, sipas kësaj rregulloreje, ose
 - 1.2. refuzohet ankesa me vendimin e komisionit të ankesave,
 - 1.3. përfshihen në listën përfundimtare subjektet, të cilave iu aprovohet ankesa si e bazuar.

Neni 12
Shpallja publike për ndarje të subvencioneve

1. Procesi i ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores MF 04/2017.
2. Në shpallje përcaktohen saktë kriteret e përgjithshme të cilat dalin nga kjo rregullore, Rregullorja MF 04/2017, si dhe kriteret specifike të fushës përkatëse, të cilat përcaktohen nga drejtoria përkatëse e kryeqytetit, varësisht prej specifikave dhe programeve të përcaktuara për subvencionim.
3. Shpallja publike qëndron e publikuar së paku 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes.

Neni 13

Kontrata për subvencionim

1. Për realizimin e subvencioneve duhet të lidhet një kontratë, me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet në mes të komunës dhe përfituesit të subvencionit.
2. Kontrata duhet t'i përcaktojë subjektet nënshkruese të kontratës, qëllimin, shumën e mjeteve financiare, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, monitorimin, formën e subvencionimit, raportimin, hyrjen në fuqi, si dhe pjesë tjera relevante për kontratën.
3. Kontrata duhet të nënshkruhet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, pas shpalljes së vendimit për ndarje të subvencioneve.

Neni 14

Subvencionet për arsim

1. Komuna mund të ndajë subvencione për arsim duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- a) bursa për studentë;
- b) bursa për nxënës të shkollave të mesme;
- c) bursa për nxënës të shkollave fillore;
- d) kuadro deficitarë;
- e) nxënës me nevoja të veçanta;
- f) gara apo kuize (aktivitete jashtëmësimore);
- g) botimin e librave/revistave;
- h) nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- i) mësimdhënës që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

2. Subvencionet për pikën a), b) dhe c) të këtij neni ndahen sipas thirrjes publike, ndërsa subvencionet për pikat d), e), f), g), h) dhe i) të këtij neni, ndahen sipas kërkesave të arsyetuara të paraqitura nga institucionet arsimore, arsimtarët, nxënësit, studentët, prindërit, si dhe nga të gjitha institucionet dhe organizatat tjera që kanë për qëllim ngritjen arsimore - edukative.

3. Kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave:

- 3.1 Kryetari i Komunës me vendim të veçantë përcakton kriteret të qarta për dhënien e bursave duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- a) notën mesatare;
- b) numrin e studentëve/nxënësve në familje;
- c) kategoritë e dala nga lufta (vetëm për studentë);
- d) banimin në zona rurale;
- e) rezultatet në gara;
- f) gjendjen ekonomike;

- g) mungesën e prindërve të studentit;
- h) aftësinë e kufizuar të studentit.

3.2 Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë:

- a) dokumentin e identifikimit;
- b) certifikatën e notave;
- c) certifikatën e vitit kalendarik të studimeve;
- d) certifikatën e vendbanimit;
- e) dëshminë mbi gjendjen ekonomike;
- f) dëshminë se prindërit i përkasin kategorive të dala nga lufta;
- g) dëshminë për rezultate në gara.

3.3. Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë kalendarik ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga niveli qendror, ose ndonjë donator tjetër për fushën e njëjtë.

3.4. Komuna duhet të bëjë shpalljen publike për dhënien e bursave, e cila publikohet në ueb-faqen e komunës në tabelat e shpalljeve, si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e komunës, mediet sociale dhe në medie lokale.

4. Shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen do të përcaktohen me thirrjen publike sipas drejtorisë përkatëse dhe të miratuara nga Kryetari i Kryeqytetit.

6. Përfituesit e subvencioneve sipas këtij neni, duhet të jenë banorë të Komunës së Prishtinës.

Neni 15

Subvencionet për zhvillim ekonomik

1. Subvencionet për fushën e zhvillimit ekonomik dhe rural ndahen për të promovuar zhvillimin e bizneseve individuale dhe të vogla.

2. Komuna mund të ndajë subvencione për zhvillim ekonomik duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- a) zeje bashkëkohore dhe tradicionale;
- b) agrobiznes;
- c) teknologji informative;
- d) ndërmarrje publike;
- e) biznes inovativ;
- f) ndërmarrje sociale;
- g) aktivitetet e shoqatave që ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmit;
- h) inkubatorët e biznesit;
- i) bizneset e reja ose fillestare;
- j) aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njerëzore për zhvillim të biznesit;
- k) aktivitetet për hulumtime të tregut;
- l) inkurajimin e punësimit të qëndrueshëm të gjinisë së nënpërfaqësuar në këtë sektor.

3. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në Komunën e Prishtinës.

4. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara komunale dhe të ATK-së.

Neni 16

Përparësitë gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik, në kushte të barabarta, komuna u jep përparësi rasteve specifike, si në vijim:

- a) bizneseve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që gjenerojnë punësim;
- b) grave, të rinjve, veprimtarive në zona rurale, personave me nevoja të veçanta dhe minoriteteve etnike;
- c) bizneseve të cilat posedojnë dëshmi apo certifikime profesionale;
- d) OJQ-ve të cilat aplikojnë me projekte biznesi, që mundësojnë gjenerim të vendeve të punës;
- e) bizneseve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë kalendarik nuk kanë qenë përfitues të një subvencionit për zhvillim ekonomik, të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për zhvillim ekonomik, përfshijnë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- a) planin e biznesit;
- b) dokument identifikues;
- c) certifikatën e vendbanimit (për persona fizikë);
- d) certifikatën e biznesit;
- e) dëshminë për pagesën e taksave komunale;
- f) dëshminë për pagesën e tatimit në pronë;
- g) dëshminë se nuk ka obligime ndaj ATK-së,
- h) dëshminë për bashkëfinancim (nëse ka bashkëfinancim);
- i) konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit).

3. Shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çdo vit fiskal në thirrjen publike të shpallur nga drejtoria përkatëse.

Neni 17

Subvencionet për bujqësi

1. Komuna mund të ndajë subvencione për bujqësi duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:
 - a) projekte të fermerëve, shoqatave bujqësore, kooperativave bujqësore, në fushat bujqësore me prioritet për komunën;
 - b) organizimin e panairëve, seminareve, vizitave studimore;
 - c) mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim;
 - d) projekte në sektorin e pylltarisë;
 - e) përkrahjen për zhvillim dhe turizëm rural.

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve në bujqësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi:
 - a) zonave me prioritet të identifikuar nga komuna;
 - b) pjesëmarrjes së fermerit në bashkëfinancim me 20% të vlerës, me përjashtim kur në ftesën publike është përcaktuar ndryshe;
 - c) grave, të rinjve, personave me nevoja të veçanta dhe minoriteteve etnike;
 - d) aplikuesve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë kalendarik nuk kanë qenë përfitues të ndonjë subvencionit për bujqësi, të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat juridikë, përfshijnë, por duke mos u kufizuar vetëm në:
 - a) certifikatë të biznesit;
 - b) projektin dhe planin financiar;
 - c) certifikatën e pronës;
 - d) dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - e) dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - f) dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
 - g) konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
 - h) dokumentin identifikues të personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve dhe autorizimit;
 - i) dëshmi se nuk është përfitues i një subvencionit të ndarë nga pushteti qendror në këtë fushë brenda vitit fiskal.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat fizikë, përfshijnë, por duke mos u kufizuar vetëm në:
 - a) dokumentin identifikues;
 - b) numrin identifikues të fermerit;
 - c) projektin dhe planin financiar;
 - d) certifikatën e pronësisë;
 - e) dëshminë për pagesën e taksave komunale;
 - f) dëshminë për pagesën e tatimit në pronë;

g) konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit.

5. Shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çdo vit fiskal në thirrjen publike të shpallur nga drejtoria përkatëse.

Neni 18

Subvencionet në lëmin e shëndetësisë

1. Komuna ndan subvencione për qytetarët të cilët janë rezidentë, për përballimin e shpenzimeve të shërimit apo mjekimit, sipas kritereve të përcaktuara në vijim.

2. Subvencionet për shëndetësi jepen në vijim, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- a) sëmundjet malinje;
- b) sëmundjet e rënda kronike të shoqëruara edhe me çrregullime të sistemeve tjera;
- c) sëmundjet, terapia e të cilave nuk janë të përfshira në listë esenciale;
 - d) terapia pas ndërhyrjeve kirurgjike me kohëzgjatje mbi 12 muaj;
 - e) lehonat - problemet e shfaqura gjatë kësaj periudhe.

3. Gjatë ndarjes së subvencioneve në shëndetësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike, duke pasur parasysh:

- a) numrin e anëtarëve të familjes;
- b) çështjen e banimit;
- c) koston e taktimit;
- d) gjendjen ekonomike familjare;
- e) trajtimin në institucionet private vendore (nëse një sëmundje e tillë nuk mund të trajtohet në institucionet publike).

4. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen nga personat fizikë gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për shëndetësi:

- a) dëshmia e diagnozës nga mjeku specialist;
- b) dokumenti i identifikimit;
- c) konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit, ose nga personi kujdestar ligjor;
- d) dëshmi për gjendjen ekonomike familjare (se është rast në situatë të vështirë socio-ekonomike);
- e) trajtimi në institucionet private vendore (nëse një sëmundje e tillë nuk mund të trajtohet në institucionet publike).

3. Shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çdo vit fiskal në thirrjen publike të shpallur nga drejtoria përkatëse.

Neni 19

Subvencionet në lëmin e mirëqenies sociale për individë dhe familje

1. Në rast të varfërisë së skajshme të individit apo familjes, të fatkeqësive natyrore, të familjeve me përkujdesje të fëmijëve me çrregullime të përhershme shëndetësore, me fëmijë dhe persona të moshës madhore, të cilët janë persona me aftësi të kufizuara dhe që janë banorë të Komunës së Prishtinës, Kryetari i Komunës në bazë të kërkesave të arsyetuara, ndan subvencione momentale të njehershme dhe forma të tjera të mbështetjes financiare nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, sipas ndarjeve të aprovuara me buxhet të komunës.
2. Të drejtë aplikimi për përfitimin e ndihmës momentale dhe të njehershme, kanë të gjitha familjet apo individët, pavarësisht a janë apo nuk janë shfrytëzues të skemës së ndihmës sociale të përcaktuar me legjislacionin në fuqi.
3. Kërkesa për ndihmë momentale të njehershme, e bërë nga individ/familja, dorëzohet në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në Komunën e Prishtinës.
4. Familjet apo individët, si dhe subjektet juridike jofitimprurëse, për të njëjtën nevojë mund të aplikojnë vetëm njëherë brenda vitit kalendarik, përjashtuar rastet e jashtëzakonshme nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore, të cilat i konstaton komisioni përkatës nëpërmjet vizitës në terren dhe mund të kërkohet konstatim shtesë i gjendjes socio-ekonomike nga Qendra për Punë Sociale/Njësia përkatëse sipas territorit.
5. Mbështetja financiare dhe ndihma momentale e njehershme nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, përjashtojnë të gjitha pagesat dhe transferet për qëllime kapitale.
6. Këto subvencione janë pagesa të njëanshme, jo të kthyeshme për individët, familjet dhe institucionet joprofitabile.
7. Kërkesa për ndihmë të njehershme mund të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas momentit të ndodhjes së rastit të jashtëzakonshëm.
8. Krahas kërkesës për ndihmë momentale të njehershme, parashtuesi i kërkesës duhet të paraqesë këto dokumente:
 - a) dokumentin e identifikimit - fotokopje e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
 - b) kopjen e lejeqëndrimit (për shtetasit e huaj: azilkërkuesit, refugjatët dhe personat të cilët gëzojnë mbrojtje të përkohshme);
 - c) konfirmimin/vërtetimin mbi llogarinë bankare - kartela bankare;
 - d) dëshminë e vërtetuar nga ana e organeve kompetente komunale, si: certifikatën e vdekjes për anëtarë të familjes;
 - e) fatkeqësitë natyrore - procesverbali për dëme të shkaktuara, apo raportin e hartuar nga komisioni profesional për pasojat nga zjarri, vërshimet, tërmeti etj;
 - f) procesverbalin e policisë për paraqitjen e humbjes së dokumenteve, së bashku me para ose ndonjë fakt tjetër;

- g) konstatimin nga kolegji i mjekëve apo fletëlëshimin e spitalit si dëshmi për gjendjen e rëndë shëndetësore;
- h) dëshmi për shpenzimet mjekësore dhe shpenzimet tjera.

Neni 20

Qiraja joprofitabile e subvencionuar për pagesë familjeve apo individëve me gjendje të rëndë sociale, të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit

1. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës planifikimin buxhetor për pagesën e qirave për familjet apo individët në nevojë përmes miratimit vjetor të buxhetit.
2. Komuna ka të drejtën e pagesës së qirave për familjet apo individët e Komunës së Prishtinës që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, të cilët jo domosdoshmërisht duhet të jenë përfitues të skemës sociale, për gjendjen e së cilës/it konstaton komisioni përkatës nëpërmjet vizitës në terren.
3. Numri i familjeve apo individëve përfitues nga kjo kategori përcaktohet në pajtim me ndarjen buxhetore sipas paragrafit 1 të këtij neni.
4. Të drejtën e subvencionimit e kanë banorët, të cilët në Komunën e Prishtinës janë rezidentë së paku prej pesë (5) viteve.
5. Qiraja e subvencionuar nga buxheti i komunës nuk mund të kalojë shumën prej treqind (300 €) euro, për një (1) muaj.

Neni 21

Përcaktimi i kriterëve dhe i radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve apo individëve në gjendje të nevojës, të cilat mund të subvencionohen për pagesën e qirasë

1. Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë për sigurimin e banimit për personat dhe familjet e paraqitura janë:

- a) statusi i banimit;
- b) lartësia e të ardhurave;
- c) gjendja shëndetësore;
- d) të ketë përjetuar ose përballur kërcënimin e dhunës në familje;
- e) invaliditeti, dhe
- f) struktura e familjes.

2. Për secilin kriter të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, Drejtoria përkatëse për Mirëqenie Sociale i propozon kriteret specifike, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve për pagesën e qirasë, të cilat do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për çdo vit fiskal.

Neni 22
Përparësitë në përzgjedhjen e familjeve të subvencionuara

1. Përparësi në përzgjedhjen e përfituesve për subvencionim të qirasë kanë:

- a) familjet me shumë fëmijë;
- b) familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me aftësi të kufizuar;
- c) familjet ku kryefamiljari është grua – mbajtëse e familjes;
- d) bashkëshorti ose bashkëshortja e shkurorëzuar që ka në përkujdesje fëmijë;
- e) personat që kanë vuajtur ose janë në rrezik të pësojnë dhunë në familje, dhe
- f) fëmijët me statusin e jetimit.

Neni 23
Afati për pagesën e qirasë së banimit

1. Pas aprovimit të propozimeve nga Kryetari i Komunës, drejtori i drejtorisë përkatëse, lidh kontratë me pronarin e banimit ku përfitues është familja apo individ që i plotëson kriteret sipas kësaj rregulloreje.

2. Pagesa e qirasë së banimit nuk mund të bëhet më tepër se për pesë (5) vite.

Neni 24
Rastet e ndërprerjes së subvencionit të qirasë apo shkëputjes së kontratës së qirasë

1. Palës përfituese të subvencionimit të qirasë, i ndërpritet e drejta për pagesë apo shkëputje e kontratës së qirasë, kur:

- a) qiramarrësi ka bërë deklarin të rrejshëm për të ardhurat;
- b) qiramarrësi ka përfitur një banesë tjetër dhe nuk e ka njoftuar organin kompetent të komunës;
- c) qiramarrësi ia lëshon banesën me qira palës së tretë;
- d) qiramarrësit i përmirësohet gjendja ekonomike, të cilin fakt e vlerëson në baza vjetore Komisioni vlerësues i komunës;
- e) qiramarrësit i punësohet njëri nga anëtarët e familjes me pagë mbi minimale;
- f) qiramarrësi i kalon pesë (5) vite nga momenti i lidhjes së kontratës.

Neni 25
Subvencione për skema të veçanta

1. Komuna ndan subvencione:

- 1.1. për lehonat, të cilat janë pjesë e Skemës së ndihmës sociale, ju jepet nënave lehona, të cilat lindin fëmijë, janë pjesë e SNS-së dhe janë banorë rezidentë të Komunës së Prishtinës.

- 1.2. për viktimat e dhunës në familje, përfituesit e së cilit mund të aplikojnë për mbështetje në komponentë të caktuara;
 - 1.3. për familjet strehuese, të cilët strehojnë fëmijët dhe të rritur pa perkujdesje prindërore;
 - 1.4. për ngrohje, në varësi të mundësive buxhetore të vitit fiskal, ndan të drejtën për ndarjen e subvencioneve të njëhershme, për ofrimin e ndihmës për furnizim me ngrohje për familjet me skemë të ndihmës sociale.
2. Kriteret, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve, kategoritë dhe shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çdo vit fiskal në thirrjen publike të shpallur nga drejtoria përkatëse.

Neni 26

Subvencionet për OJQ-të që ofrojnë shërbimet sociale

1. Komuna ndan subvencione për OJQ-të për ofrimin e shërbimeve sociale.
2. Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë **kriteret e përgjithshme minimale** të përcaktuara me dispozitat në vijim:
 - 1.1. të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare në Republikën e Kosovës;
 - 1.2. të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
 - 1.3. të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
 - 1.4. të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete, dhe
 - 1.5. të moskzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
3. Me qëllim të dëshmisë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, për paragrafët 1.1 dhe 1.2. të këtij neni, aplikuesi dorëzon certifikatat përkatëse dhe për paragrafët 1.3, 1.4, si dhe 1.5. aplikuesi nënshkruan dhe dorëzon deklaratat përkatëse.
4. Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme, aplikuesi nuk mund të kualifikohet për mbështetje financiare.
5. Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë edhe kriteret specifike minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:
 - 1.1. të dorëzojnë brenda afatit të thirrjes projektpropozimin i cili ndër të tjera përmban të dhënat për qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të dhënat tjera sipas formularit përkatës të përcaktuar sipas thirrjes publike;

- 1.2. projektpropozimi të jetë i shoqëruar me një propozim-buxhet;
 - 1.3. të dorëzojë të dhëna për personelin kyç, duke specifikuar detyrat e tyre, siguruar CV-të e tyre së bashku me një deklaratë pranimi nga ana e tyre se do të punojnë për projektin/programin, në rast të përfitimit të mbështetjes financiare, nëse kjo është e domosdoshme sipas thirrjes;
 - 1.4. të sigurojnë dëshmitë e duhura për projektet për të cilat kërkohet bashkëfinancim, nëse është e aplikueshme;
 - 1.5. të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e projekteve/programeve të ngjashme duke siguruar dëshmi të realizimit të projekteve të ngjashme në të kaluarën, nëse kjo është e domosdoshme sipas thirrjes përkatëse, dhe
 - 1.6. të paraqesin leje/licencë për ushtrimin e veprimtarisë në rastet kur me legjislacionin në fuqi ushtrimi i një veprimtarie të tillë mund të kryhet vetëm me leje/licencë nga autoritetet publike.
6. Kërkesa tjera specifike që mund të jenë të nevojshme për një program apo projekt specifik sipas thirrjes publike mund të përcaktohen nga ofruesit e mbështetjes financiare dhe ato duhet të jenë në përputhje me parimet e përcaktuara të kësaj rregulloreje.
 7. Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret specifike, aplikacioni do të konsiderohet i pakompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.
 8. Aplikanti duhet të dëshmojë se i plotëson kriteret specifike duke dorëzuar dokumentet përkatëse sipas dispozitave të këtij neni dhe thirrjes publike.

Neni 27

Subvencionet për kulturë, rini, sport

1. Komuna mund të ndajë subvencione për kulturë, rini dhe sport, duke përfshirë:

1.1 *Fushën e kulturës*

- a) **Art vizual – figurativ:** krijim i veprës së re, fuqizimi i artistëve të rinj, ekspozitë, hulumtim kuratorial, instalime në hapësira publike, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik;
- b) **Botime:** për fëmijë, për të rinj, romane, tregime, përkthime, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe hulumtime kulturore;
- c) **Festival:** art figurativ, art në hapësira publike, arkitekturë, ekologji, film, letrar, shumëdisiplinor, muzikë, folklor, teatër, teknologji informative, vallëzim etj.;
- d) **Kinematografi:** film dokumentar, film i shkurtër, film i animuar, fuqizimi i kinematografëve të rinj, titrim dhe zhvillim skenari;

e) **Manifestime:** shënimi i datave historike, shënimi i festave kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe shënimi i datave tjera me rëndësi në Komunën e Prishtinës;

f) **Mbështetje e aktiviteteve vjetore të organizatave dhe operatorëve kulturorë:** aktivitete mujore, programe arsimore, fuqizim i krijuesve të rinj, rezidencë artistike, debate, ligjërata dhe hulumtime;

g) **Muzikë:** kompozim i veprës së re, audio-incizim, koncert, fuqizim i muzikantëve të rinj, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik;

h) **Organizim:** performancë, trajnim, punëtori, debat, tryezë, ligjërata, simpozium dhe konferencë;

i) **Shoqëri kulturo-artistike:** mbështetje e aktiviteteve vjetore, blerja e kostumeve, blerja e instrumenteve dhe pjesëmarrje në festivale;

j) **Teatër:** prodhim i shfaqjes, promovim dhe pjesëmarrje e shfaqjes në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik;

k) **Trashëgimi kulturore:** ciceroni i Prishtinës, fushata vetëdijesimi, pjesëmarrje aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, hulumtim i trashëgimisë kulturore në Komunën e Prishtinës, promovim i diversitetit kulturor në Komunën e Prishtinës, turizëm kulturor në Komunën e Prishtinës, platforma informative dhe inovacion teknologjik;

l) **Shpërblime vjetore:** vepra më e mirë e vitit, krijuesit e vitit, ngjarja kulturore e vitit, projekti kulturor i vitit dhe operatori kulturor i vitit.

1.2. Fushën e rinisë

a) **Fuqizimi i organizatave rinore:** mbështetja e aktiviteteve të OJQ-ve, promovimi i vullnetarizmit, integrimi i grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara, pjesëmarrje në seminare, konferenca etj., brenda dhe jashtë vendit, mbështetja e ideve - projekteve të rinjve, si dhe promovimi i talentëve të rinj;

b) **Edukimi joformal:** trajnime, punëtori, debate, tryeza, ligjërata, hulumtime, simpoziume, konferenca etj.;

c) **Shpërblime vjetore:** vullnetari i vitit, ngjarja rinore e vitit, projekti rinor i vitit dhe organizata rinore e vitit.

1.3 Fushën e sportit

a) **Masivizimi i sportit:** masivizimi i sportit për të rinj, avancimi i aktiviteteve në klubet sportive të femrave, integrimi i minoriteteve në aktivitete dhe gara sportive, integrimi i personave me aftësi të kufizuara në aktivitete dhe gara sportive, mbështetje e aktiviteteve

sportive për fëmijët e Prishtinës, përkrahja e projekteve me qëllim të zhvillimit të ligave shkollore në nivel lokal dhe rajonal;

b) **Ngritja e kapacitetit në fushën e sportit:** përkrahja e klubeve publike sportive, përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet e suksesshme, bashkëpunimi me organizata të ndryshme sportive, vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të realizimit të projekteve për avancimin e trajnerëve, të cilët punojnë me grupmosha të ndryshme, ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive, si dhe aktivitete edukative me simpatizantë, me qëllim të evitimit të dhunës dhe kultivimit të vlerave fisnike të sportit;

c) **Organizime:** trajnime, punëtori, debate, tryeza, ligjërata, hulumtime, simpoziume, konferenca, mbështetje të personave me nevoja të veçanta etj.;

d) **Shpërblime vjetore:** sportistët/ laureatët e sportit, shpresa e sportit, ngjarja sportive e vitit, klubi sportiv i vitit dhe individët e inkuadruar në sport si punëtorë profesionalë (trajnerë, referë, përzgjedhës, pedagogë, punëtorë sportivë, veteranë të sportit, gazetarë sportivë etj.).

2. Procesi i ndarjes së subvencioneve për kulturë, rini dhe sport do të bëhet përmes platformës digjitale të Komunës së Prishtinës.

3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve, përfshijnë:

- a) projektopozimin;
- b) plotësimin e aplikacionit digjital;
- c) dokumentin identifikues;
- d) certifikatën e regjistrimit (për persona juridikë);
- e) certifikatën e numrit fiskal (për persona juridikë);
- f) konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
- g) dëshminë për fonde të siguruara (nëse aplikohet);
- h) dokumentet që kërkohen sipas kriterëve në thirrjet e publikuara.

4. Shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çdo vit fiskal në thirrjen publike të shpallur nga drejtoritë përkatëse.

Neni 28

Shpenzimet për funeral

Komuna mund të ndajë subvencione për shpenzimet e funeralit për anëtarët e ngushtë të personit të vdekur, deri në shumën e paraparë prej 300 euro.

Neni 29

Kriteret dhe dokumentet që nevojiten për mbulimin e shpenzimeve të funeralit

1. Komuna mund të ndajë subvencione për shpenzimet e funeralit, për qytetarët që janë familjarë të ngushtë të personave që kanë ndërruar jetë, sipas dokumentacionit të cekur si në vijim:

- a) faturën për shërbimet e marra nga ndërmarrja publike lokale "Gjelbër" SHA;
- b) faturën nga bashkësia fetare, përmes së cilës janë kryer ritet fetare për personin e vdekur, në rast se funerali i nënshtrohet ritualeve fetare;
- c) faturën nga kompania përkatëse që është shfrytëzuar për transportimin e kufomës të personit të vdekur.

2. Personat që e shfrytëzojnë të drejtën e përcaktuar si në nenin 28, duhet t'i paraqesin dokumentet si në vijim:

- a) ekstraktin e lindjes së personit që ka ndërruar jetë;
- b) certifikatën e vdekjes të personit familjar;
- c) dokumentin e identifikimit të familjarit të ngushtë, së bashku me numrin e xhirollogarisë bankare.

3. Subvencionimi i së drejtës të paraparë sipas nenit 28, nuk mund të kalojë periudhën kohore prej 90 ditësh, duke llogaritur nga data e vdekjes.

4. E drejta e paraparë sipas nenit 28, shterohet me shfrytëzimin e së njëjtës nga familjari i parë që paraqitet para organeve komunale.

Neni 30

Subvencionet e ndara me vendim të Kuvendit të Kryeqytetit

1. Me vendim të Kuvendit të Kryeqytetit ndahen subvencionet si në vijim:

- a) Subvencionet për Ndërmarrjet publike lokale të kryeqytetit ose në ato ku kryeqyteti është aksionar;
- b) Subvencionet për kopshtet e fëmijëve me bazë në komunitet ose për institucione tjera në të cilat Komuna e Prishtinës ka interes publik;
- c) Subvencionet në fushat e përcaktuara me këtë rregullore, të cilat e kalojnë shumën mbi 20,000 mijë euro.

2. Propozimet në Kuvend të Kryeqytetit për ndarjen e subvencioneve sipas këtij neni dërgohen nga Kryetari i Kryeqytetit.

Neni 31
Raportet kthyesë nga përfituesit e subvencioneve

1. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit, të dorëzojnë në komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare, ashtu siç janë kërkuar me projektpropozim. Raporti duhet t'i ketë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve etj.
2. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas përfitimit të subvencioneve të dorëzojnë raportin narrativ, i cili duhet t'i ketë të gjitha të dhënat e aktiviteteve që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit, duke përfshirë të dhënat për përfituesit të ndara sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike dhe aftësisë.
3. Periudha kohore e raportimit duhet të jetë 30 ditë kalendarike pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në marrëveshje në mes palës përfituese dhe komunës.
4. Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni, protokollohen dhe një kopje e tyre dorëzohet në arkivin e komunës.

Neni 32
Monitorimi i përfituesve të subvencioneve

1. Komuna ka të drejtë të iniciojë auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga komuna në formë të subvencioneve.
2. Komuna bën monitorimin e përfituesve të subvencioneve, me theks të veçantë të përfituesve në fushat e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas vendimit, apo marrëveshjes për mjetet e ndara në formë të subvencioneve.
3. Monitorimi sipas paragrafit 2 të këtij neni, bëhet në periudhën kohore deri në 3 vjet nga data e përfitimit të subvencionit.

Neni 33
Transparenca në ndarjen e subvencioneve

1. Komuna publikon listën përfundimtare të përfituesve të subvencioneve brenda 2 ditë pune pas vendimit për ndarje të subvencioneve nga kryetari.
2. Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbajë: emrin e përfituesit, rastin, fushën për të cilën jepet subvencioni dhe shumat që u janë ndarë, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Po ashtu do të publikohen përshkrimet e projekteve përfituese dhe arsyetimi për subvencionim.

3. Përfshirje nga paragrafi 1 i këtij neni, komuna nuk i publikon subvencionet për rastet e përcaktuara në nenin 18, paragrafi 2, pikat a), b), c), neni 21 d), dhe neni 22 e).

4. Publikimi i vendimeve dhe i përfituesve nga ndarja e subvencioneve, bëhet në ueb-faqen e komunës, në tabelat e shpalljeve, si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e komunës.

5. Komuna do t'i publikojë në ueb-faqen e saj raportet nga përfituesit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga miratimi i raportit nga komuna, ku përfshihen: emri i përfituesit, rasti, fusha për të cilën jepen subvencionet dhe shumat që janë ndarë, dhe numrin e përfituesve të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike, moshës dhe aftësisë të kufizuar. Kjo nuk do të zbatohet për subvencionet e dhëna sipas paragrafit 3 të këtij neni, për të cilat vetëm numri i përgjithshëm i përfituesve të ndarë sipas gjinisë dhe etnisë, moshës dhe aftësisë së kufizuar do të publikohen si numër total në vit me shumën totale të parashikuar dhe qëllimin e saj.

Neni 34

Dispozitat kalimtare dhe shfuqizuese

1. Ndarja e subvencioneve e filluar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, vazhdon me rregullativën ekzistuese, pavarësisht nëse kjo rregullore hyn në fuqi.

2. Pagesat sipas nenit 29 të kësaj rregulloreje do të aplikohen nga data 1.1.2025. Nëse pas datës 1.1.2025, janë kryer pagesat sipas këtij neni në shumën e mëparshme të përcaktuar prej 210 euro, atëherë do të paguhet diferenca e pagesës në vlerë prej 90 euro.

3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja nr. 01-020/01-194101/18 e dt. 8.8.2018.

Neni 35

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pune pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-011/01-79067/25, më 4.6.2025

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

